

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump refuzon armëpushimin me Iranin, pritet rifillimi i bombardimeve pas zgjedhjeve të nëntorit - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/trump-refuzon-armepushimin-me-iranin-pritet-rifillimi-i-bombardimeve-pas-zgjedhjeve-te-nentorit/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:47:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:42:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e0dd323eb9bc633061d77d765b333f2797d668e1e4755e1ea854fa781b63f471
TEKSTI	e6d5989212fab322160f80ed5cd2afcb7d9ce68745f3ea33ae8283213ec75a66
PAMJA	5c18b44cb47e2feed58a8e4c2d43d6cfd546d5893da04e35e14641b34ad4b876

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	91ab770dd2eeb25bd919b322c2080631e238d39facd5282602343a315b959352
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a38a4fa799b1e73bbabeaa0ef113694411dbd892b18eb619eb2f3db166512539
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/91ab770dd2eeb25bd919b322c2080631e238d39facd5282602343a315b959352>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Donald Trump SHBA Edi Rama Inteligjenca Artificiale Gjyqi i UÇK

BOTA

Trump refuzon armëpushimin me Iranin, pritet rifillimi i bombardimeve pas zgjedhjeve të nëntorit

26 Shtator 2026 | 08:42

Presidenti amerikan Donald Trump ka hedhur poshtë propozimin e Iranit për një armëpushim shtatëditor dhe u ka thënë bashkëpunëtorëve të tij se pret të rifillojë bombardimet ndaj Iranit pas zgjedhjeve të mesmandatit të nëntorit, sipas "Wall Street Journal".

Propozimi i Teheranit parashikonte ndërprerjen e luftimeve në rajon dhe rihapjen brenda shtatë ditësh të Ngushticës së Hormuzit, një prej rrugëve më të rëndësishme për transportin botëror të naftës dhe gazit. Plan i u përroll Uashingtonit përmes ndërmjetësve nga Katari.

Në këmbim, Irani kërkonte që Shtetet e Bashkuara të hiqnin bllokadën detare ndaj porteve iraniane, të lehtësonin sanksionet ndaj eksporteve të naftës dhe të zhblokonin asetet iraniane të ngrira. Plan i parashikonte gjithashtu ndërprerjen e luftimeve në fronte të tjera të rajonit, përfshirë Libanin. Pas përfundimit të periudhës shtatëditore, Uashingtoni dhe Teherani do të nisinin negociatat më të gjera, përfshirë për programin bërthamor iranian.

Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, deklaroi në OKB se zbatimi i planit mund të niste menjëherë sapo SHBA-ja ta pranonte atë, duke ia lënë Uashingtonit vendimin për marrëveshjen. Presidenti iranian Masoud Pezeshkian tha gjithashtu se forcat iraniane do t'i përmbaheshin planit nëse ai pranohej nga pala amerikane.

Por sipas "Wall Street Journal", Trump mbetet skeptik se Teherani do të pranonte kërkesat amerikane për programin e tij bërthamor. Administrata amerikane i ka bërë të ditur Iranit dhe ndërmjetësve se nuk synon të heqë bllokadën detare, duke llogaritur se presioni ekonomik do ta detyrojë Teheranin të pranojë një marrëveshje me kushte të tjera.

Propozimi iranian erdhi në një kohë kur negociatorët amerikanë po përpiqeshin të rigjallëronin diplomacinë me Iranin lidhur me programin bërthamor, përmes bisedimeve të zhvilluara në kuadër të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, deklaroi se një takim treorësh mes zyrtarëve amerikanë dhe iranianë, i ndërmjetësuar nga Katari, nuk solli ndonjë përparim të rëndësishëm.

LAJMI I FUNDIT

08:23 Pas tre vitesh Shqipëria zyrtarisht me Ambasador të SHBA në Tiranë, Eric Wendt dorëzon sot kredencialet te Begaj

08:14 Aksident tragjik në Fushë-Krujë, përplasen tre automjete! Humb jetën një person, plagosen dy të tjerë

08:13 Breshëri plumbash drejt një kafeneje në Athinë, plagoset një vajzë 10-vjeçare shqiptare

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

08:07 Botët OpenAI ndërhynë në faqet e shumta të agjencive qeveritare amerikane

23:46 Limaj në protestën "Jo në emrin tim": UÇK-ja është identitet i këtij kombi dhe i lirisë

22:27 Vetëvrasje apo vrasje? Dokumente të reja rihapin misterin e mbesës së Hitlerit

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | LAJM KRYESOR

Botët OpenAI ndërhyjnë në faqet e shumta të agjencive qeveritare amerikane

OpenAI ka pranuar se ka alarmuar "dhjetëra" institucione globale se faqet e tyre të internetit mund të jenë ndërhyrë nga robotët e saj të inteligjencës...

08:07 | 26/09/2026

BOTA

Vetëvrasje apo vrasje? Dokumente të reja rihapin misterin e mbesës së Hitlerit

Një sërë dokumentesh arkivore të zbuluara herë pas here ngre dyshime të forta që Adolf Hitleri mund të ketë vrarë mbesën e tij, e cila...

22:27 | 25/09/2026

BOTA

Papa: Inteligjenca artificiale duhet t'u shërbejë njerëzve, jo të bëhet instrument dominimi

Papa Leo XIV paralajmëroi të premtën kundër rreziqeve të inteligjencës artificiale, duke deklaruar se teknologjitë e reja duhet të "mbeten në shërbim të personit njerëzor",...

22:19 | 25/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara
Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

KOMPANIA

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.